


## E RËNDËSISHME!

VAKSINIMI PËR PERSONAT MBI 65 VJET ËSHTË **FALAS!**

Vaksinimi kundër gripit nuk garanton 100% siguri se i personi i vaksinuar nuk do sëmuret nga gripi, por edhe nëse sëmuret, sëmundja do të ketë një formë më të lehtë, ndërsa rreziku nga komplikimet, hospitalizimi dhe vdekja do të zvogëlohet ndjeshëm.

Nuk rekomandohet përdorimi i barnave për parandalimin e gripit!




### CAKTONI TERMIN PËR VAKSINIM NËPËRMJET PLATFORMËS ONLINE!

Caktimi i termineve për vaksinim me vakcina falas bëhet nëpërmjet ueb-faqes [www.vaksinacija.mk](http://www.vaksinacija.mk)

Me plotësimin e formularit ju regjistroheni për vaksinim drejtpërdrejt në sistemin Termini Im. Me anë të një mesazhi SMS ju do të informoheni për datën dhe orën e saktë të vaksinimit në pikën e vaksinimit që e keni zgjidhur gjatë regjistrimit.

Përveç këtyre vaksinave, ju mund të vaksinoheni me vakcina komerciale kundër gripit sezonal në Qendrën më të afërt të Shëndetit Publik pa caktuar paraprakisht një termin.



## NËSE JENI 65 OSE MË SHUMË VJET

### A E DINI SE GRIPI APO INFLU-ENCA mund të jetë një sëmundje serioze, sidomos për personat më të moshuar?

PERSONAT QË JANË 65 OSE MË SHUMË VJET MBAJNË BARRËN MË TË RËNDË NGA FORMAT E RËNDA TË SËMUNDJES.



**FAKT: Personat mbi 65 vjet janë më të rrezikuar nga zhvillimi i komplikimeve të rënda nga gripi, për dallim nga personat e rinj e të shëndetshëm.**

Ky dallim pjesërisht është si rezultat i:

- ndryshimeve në sistemin mbrojtës imunologjik si pasojë e moshës.
- personat mbi 65 vjet të cilët vuajnë nga sëmundje kronike kanë një faktor shtesë që i vendos ata në një rrezik më të lartë nga komplikimet e rënda të gripit.

*Vlerësohet se 70 deri më 85 përqind e rasteve të vdekjes si pasojë e gripit sezonal kanë ndodhur tek personat mbi 65 vjet, ndërsa nga 50 deri më 70 përqind e rasteve të hospitalizimeve sezonale lidhur me gripin kanë ndodhur tek personat e kësaj grupmoshe.*

*(Burimi: CDC)*



**FAKT: Vaksinimi sezonal kundër gripit është mënyra më e mirë për ta zvogëluar rrezikun nga gripi dhe potenciali i tij për të shkaktuar komplikime të rënda.**

Vaksinimi e zvogëlon rrezikun nga gripi dhe nga shfaqja e komplikimeve të rënda që mund të kenë si rezultat hospitalizim ose madje edhe vdekje tek personat më të moshuar.

Vaksina kundër gripit mbron nga viruset e gripit që do jenë dominantë gjatë sezonit të ardhshëm.

**VAKSINAT KUNDËR GRIPIT JANË TË SIGURTA DHE NUK SHKAKTOJNË GRIP.**

**VAKSINIMI VJETOR KUNDËR GRIPIT SEZONAL NDIHMON NË SIGURIMIN E MBROJTJES MË TË MIRË TË MUNDSHME KUNDËR GRIPIT.**

**FAKT: Efektet e padëshiruara të vaksinave kundër gripit janë të buta krahasuar me pasojat e mundshme të rënda të infeksionit me virusin e gripit.**

Pas marrjes së vaksinës kundër gripit mund të përjetoni disa efekte të padëshiruara që zakonisht janë të lehta si dhimbje, ndjeshmëri, skuqje dhe/ose ënjtje në vendin e injektimit të vaksinës.

Ndonjëherë mund të keni dhimbje të kokës, ethe dhe nauze ose të ndjeheni të lodhur.

